



KOMUNA E VUSHTRRIË

TASK Forca

Plani për zhvillimin e mësimit në kushte pandemie për vitin shkollo 2020/2021

Duke marrë për bazë kufizimin nga MASH për qëndrimin maksimal të nxënësve në shkollë që është 120 minuta, për dy javët e para, me qëllim të ambientimit të fëmijëve dhe punonjësve për mësime në shkollë në kushte pandemie dhe këto dy javë të shfrytëzohen më tepër për të udhëzuar nxënësit për respektimin e masave mbrojtëse dhe sjelljet në shkollë si dhe përsëritje të lëndëve nga viti i kaluar, mendojmë që mësime ditore në shkollë të mbahet tri orë mësime me nga 30 minuta, pushimi në mes të orëve 1-2, 5 minuta, kurse 2-3, 10 minuta, lëndët e përgjithshme gjuhë shqipe, matematikë dhe javën e parë, për nivelin fillorë e vendos shkolla se cilat lëndë mbahen në shkollë e cilat ndjekën online ose TV, kurse për nivelin e mesëm të ulët lëndët e shkencave natyrore fizikë, biologji, kimi kurse javën e dytë lëndët e shkencave shoqërore histori, gjeografi, ed.qytetare. Gjatë javës që lëndët e shkencave natyrore mbahen në shkollë, lëndët e shkencave shoqërore fëmijët i ndjekin emetimet në TV kurse javën tjetër të njëjtën gjë e bëjnë për lëndët e shkencave të natyrës. Pas 2 jave, pas një analize dhe vlerësimi të situatës/gjendjes në terren, planifikojmë që në shkollë mësime ditore të mbahen 4 orë nga 25 minuta, ku pushimi mes orë 1-2 dhe 3-4 do të ishte 5 minuta kurse mes orës 2-3, 10 minuta me qëllim të ajrosjes së klasave. Gjithsej gjatë javës do të arrijmë t'i mbanim 20 orë mësimore në shkollë për klasët VI, VII, VIII dhe IX, ndërsa orët tjera do të mësime online dhe nga TV. Që të realizohet e gjithë kjo nga java e tretë e fillimit të mësimit, planifikojmë që çdo lëndë e cila I ka më shumë se një orë në javë, nga 1 orë të mbahet online ose TV, kurse tjerat në shkollë. Ky skenar do të na e lehtësonte edhe përpilimin e orarit mësimesor.

Për nivelin e mesëm të lartë do të hartohen plane veçmas!

➤ Përgjegjësitë

- TASK Forca Komunale do të mbajë takime së paku çdo dy javë (në rast nevojë edhe më shpesh).
- Takimet e TASK Forcës do të mbahen në format të plotë (vetëm nëse vlerësohet se nuk është e nevojshme prezenca e përbërjes së plotë).
- Vendimet do të merren bazuar në udhëzuesin e MASH, vlerësimi i situatës epidemiologjike dhe rekomandimeve nga institucionet shëndetësore.
- Verifikimin e skenarëve A, B dhe C me shkallën e rrezikshmërisë në territorin e komunës.
- Monitorimin e zbatimit të skenarëve.
- Përcakton masat përkrahëse për shkollat.
- Koordinon dhe menaxhon me institucionet dhe të personelin arsimor në nivel të komunës me fokus në realizimin e mësimin sipas skenarëve
- Vendosë format e vendimmarrjes, raportimit dhe vlerësimit të performancës së personelit nëpërmjet të komunikimit të KUFIZUAR fizik dhe komunikimit nëpërmjet formave të virtuale
- Realizon kolegjiun virtual me drejtorët e institucioneve arsimore për informim të rregullt, raportim dhe vlerësim të mësimin.
- Organizon takime individuale me drejtorë të institucioneve arsimore– gjithnjë duke pasur para sysh aspektet e sigurisë shëndetësore dhe mirëqenies së personelit.
- Komunikon në mënyrë efikase dhe të sigurt me Këshillin e Prindërve në nivel komunal.
- Planifikojnë sigurimin dhe shpërndarjen e teksteve shkollore me kohë të nxënësit.
- Përpilojnë evidencën e shkollave dhe mësimdhënësve që nuk kanë pajisje
- Sigurojnë pajisje të nevojshme (me ndihmën e MASH ose të donatorëve)
- Furnizojnë me pajisje për procesin edukativo arsimor në distancë (sipas fushave mësimore dhe aktiveve të klasave nëpër institucione parashkollore/shkolla (1 aktiv i klasës ose 1 fushë mësimore =1 set i pajisjeve) dhe menaxhojnë shfrytëzimin e tyre të përbashkët
- Japin udhëzimet të sakta për përgatitjen dhe ofrimin e mësimin sipas skenarëve, duke shfrytëzuar rrjetin dhe pajisjet në institucione arsimore, sipas orarit të përcaktuar
- Përcaktojnë, format e raportimit të mësimin në përputhje me udhëzimet e MASH si dhe caktojnë përkrahjen dhe informimin e nxënësve dhe prindërve
- Sigurojnë internetin e qëndrueshëm për nxënësit dhe mësimdhënësit
- Sigurojnë një zyrtar të teknologjisë informative ose mësimdhënës të dalluar të TIK, si pikë kontakti për shkolla lidhur me çështjet e digjitalizimit dhe mësimin nga distanca.

➤ **Detyrat**

- ✓ **Kryetari i komunës** – udhëheq dhe mbikëqyrë aktivitetet e TASK Forcës.
- ✓ **Drejtori i DKA-së** - informon vazhdimisht për procesin mësimor, kushteve në shkollë, verifikimin e skenarëve A, B dhe C, zbatimin e skenarëve, numrin eventual e të të infektuarve nxënës apo punonjës, furnizimet me pajisje e materiale mbrojtëse në shkolla, për çdo aktivitet a ndodhi tjetër në institucionet arsimore brenda territorit të komunës, po ashtu shtron kërkesa për mjete financiare për nevoja të shkollave dhe për çdo aktivitet a ndodhi në shkolla.
- ✓ **Drejtori i Mirëqenies sociale** – vlerëson për shërbimet e nevojshme për mirëqenie sociale, viziton shkollat për qëllime të analizës, udhëzon/këshillon e në raste të caktuara edhe trajton.
- ✓ **Drejtori i Financave** – varësisht nga nevojat dhe kërkesat e shtruarra bën llogaritjen e koston së shpenzimeve duke ju referuar kapaciteteve buxhetore të komunës si dhe siguron alokimin/nënalokimin e këtyre shumave në kohë.
- ✓ **Drejtori i Shëndetësisë** – informon me rekomandimet e IKSHP, situatën epidemiologjike dhe rekomandon në bazë të vlerësimeve, siguron vizita periodike në shkolla të punëtorëve shëndetësorë që përveç kontrolleve shëndetësore japin edhe këshilla e udhëzime për masat mbrojtëse, udhëzon për materialet dhe mënyrën e dezinfektimit të shkollave dhe i përgjigjet çdo nevoje nga aspekti shëndetësorë.
- ✓ **Inspektori Sanitar** – informon për situatën higjienike sanitare në shkolla bazuar në inspektimet periodike dhe rekomandon për masat që duhet ndërmarrë dhe i përgjigjet çdo nevoje nga aspekti higjienik-sanitarë.

Forma tabelare për aq sa u tha më lartë:

Klasa e gjashtë ka gjithsej 29 orë në javë			
Lënda	Mësim në shkollë	Mësim online dhe TV	Hiqen tërsisht
Gj.shqipe	4	1	
Gj.angleze	2		
Gj.gjermane	1		
Matematikë	3	1	
Biologji	1	1	
Fizikë	2		
Histori	1	1	
Gjeografi	1	1	
Ed.qytetare	1		
Art figurativ	1		
Ed.Muzikore	1		
Tik	1	1	
Ed.Fizike	1	1	
M.zgjedhor			2'
Totali	20	7	2 Gjithsej 29

2': Me që fondi javor i lëndëve art figurative dhe ed.muzikore është një orë, atëherë në mënyrë periodike javën e katërt në vend të këtyre lëndëve mbahen orë të mësimit zgjedhor për shkak të vlerësimit.

Klasa e shtatë ka gjithsej 30 orë në javë			
Lënda	Mësim në shkollë	Mësim online dhe në tv	Hiqen tërsisht
Gj.shqipe	4	1	
Gj.angleze	1	1	
Gj.gjermane	1		
Matematikë	3	1	
Biologji	1	1	
Fizikë	1	1	
Kimi	2		
Histori	1	1	
Gjeografi	1	1	
Ed.qytetare	1		
Art figurativ	1		
Ed.Muzikore	1		
Tik	1	1	
Ed.Fizike	1	1	
M.zgjedhor			1'
Totali	20	9	30 Gjithsej 30

1': Me që fondi javor i lëndëve art figurativë dhe ed.muzikore është një orë, atëherë në mënyrë periodike një herë në muaj në vend të këtyre lëndëve mbahen orë të mësimit zgjedhor për shkak të vlerësimit

Klasa e tetë ka gjithsej 30 orë në javë			
Lënda	Mësim në shkollë	Mësim online dhe në tv	Hiqen tërsisht
Gj.shqipe	4	1	
Gj.angleze	1	1	
Gj.gjermane	1		
Matematikë	3	1	
Biologji	1	1	
Fizikë	1	1	
Kimi	2		
Histori	1	1	
Gjeografi	1	1	
Ed.qytetare	1		
Art figurativ	1		
Ed.Muzikore	1		
Tik	1	1	
Ed.Fizike	1	1	
M.zgjedhor			1'
Totali	20	9	30 Gjithsej 30

1': Me që fondi javor i lëndëve art figurativë dhe ed.muzikore është një orë, atëherë në mënyrë periodike javën e katërt në vend të këtyre lëndëve mbahen orë të mësimit zgjedhor për shkak të vlerësimit

Klasa e nëntë ka gjithsej 30 orë në javë			
Lënda	Mësim në shkollë	Mësim online dhe në tv	Hiqen tërsisht
Gj.shqipe	3	1	
Gj.angleze	2		
Gj.gjermane	1		
Matematikë	2	1	
Biologji	1	1	
Fizikë	2		
Kimi	2		
Histori	1	1	
Gjeografi	1	1	
Ed.qytetare	1	1	
Art figurativ	1		
Ed.Muzikore	1		
Tik	1	1	
Ed.Fizike	1	1	
M.zgjedhor			2'
Totali	20	8	30 Gjithsej 30

2': Me që fondi javor i lëndëve art figurativë dhe ed.muzikore është një orë, atëherë në mënyrë periodike javën e katërt në vend të këtyre lëndëve mbahen orë të mësimit zgjedhor për shkak të vlerësimit.